



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 87, datë 27.07.2020**

**“PËR  
NJË KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 39, DATË 03.05.2019 TË  
KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT “FONDI I  
KOMUNITETEVE”, HARTUAR SIPAS UDHËZUESIT OPERACIONAL PËR ZBATIMIN E  
TIJ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 3, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 112, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

Në udhëzuesin bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të vendimit nr. 39, datë 03.05.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit “Fondi i Komuniteteve”, hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”, bëhet ndreqja e gabimit material si më poshtë:

1. Në nënndarjen IV, të paragrafit të parë të rubrikës “Detyrat e Komisionit të Komisionit të Fondit të Komuniteteve”, togfjalëshi “Një kopje të kontratës trepalëshe të lidhur ndërmjet Administratorit, Bashkisë së Tiranës dhe Firmës së kontraktuar” zëvendësohet me “Një kopje të kontratës dypalëshe të lidhur ndërmjet administratorit dhe Bashkisë Tiranë”.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhënien me Publikun dhe Jashtë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**